



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H E R

Nr. 233 Date 11.11.2005

**PËR KRIJIMIN E TASK FORCËS KUNDËR
KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT**

Me synim për te rritur cilësinë e ndjekjes penale dhe te përfaqësimit të akuzës ne gjyq të veprave penale ne fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit

Ne mbështetje te nenit 8, pika 2, germa V e ligjit Nr. 8737 date 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ

1. Ne Prokurorinë Pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane krijohet Task Forca për ushtrimin e ndjekjes penale ne fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit.
2. Ne Task Forcë bëjnë pjese Zëvendës drejtuesi i Prokurorisë Tirane, prokurore te Prokurorisë Tirane, oficere te policisë gjyqësore te seksionit te prokurorisë, si dhe oficere nga shërbimet e policisë gjyqësore.
 - 2.1. Në Task Forcë të përfshihen prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore më me përvojë në ndjekjen e çështjeve të krimit ekonomik dhe korrupsionit, për aq sa është e mundur ata që krahas arsimit juridik kanë edhe atë ekonomik, si dhe prokuroret magjistratë, të gjithë opgj-të e seksionit që vijnë nga doganat, tatimet dhe sektori i luftës kundër krimit ekonomik në Policinë e Shtetit.
3. Task Forca kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit do te drejtohet nga Drejtuesi dhe Zv. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.
4. Objekti i punës i këtij sektori do te jete ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës ne gjykate për veprat penale të parashikuara nga nenet 135, 143/a, 144, 145, 146, 163 deri 185, 186/3, 187/2, 188/2, 189/3, 190/3, 191/3, 193 deri 196, 230/c, 230/ç, 244 deri 245/1, 248, 256 deri 260, 287, 312, 319 dhe 319/a dhe 328 te Kodit Penal.
5. Task Forca do te kryeje detyrat e përcaktuara ne këtë urdhër duke filluar

nga data 15 nëntor 2005. Procedimet penale te regjistruara para kësaj date do te vazhdojnë te ndiqen nga prokuroret qe i kane ne ndjekje aktualisht, ndërsa procedimet penale te regjistruara nga data 15 nëntor 2005 e ne vazhdim do te ndiqen nga Task Forca.

6. Për çdo kallëzim, referim apo regjistrim kryesisht të procedimeve që lidhen me veprat penale, objekt i punës së Task Forcës, do të njoftohet menjëherë , por jo më vonë se 48 orë, me shkrim, Prokurori i Përgjithshëm.
7. Në vazhdimësi, por jo më rrallë se njëherë në javë, të behën analizat e çështjeve më problematike me Prokurorin e Përgjithshëm.
8. Në dispozicion të Task Forcës, për të kryer detyrat në kohë dhe me cilësi, të vihen në dispozicion mjetet e nevojshme logjistike si dhe automjete që aktualisht janë në inventarin e Prokurorisë së Tiranës. Administrata e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të ndihmojë ne plotësimin e këtyre kërkesave.
9. Në varësi të vështirësive të çështjeve dhe rezultateve pozitive në punë, drejtuesit t'i propozojnë Prokurorit të Përgjithshëm deri në 20% shtesë page si dhe shpërblime për prokuroret dhe opgj-të e Task Forcës.
10. Për te ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtuesit e Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoritë pranë Zyrës se Prokurorit te Përgjithshëm.
11. Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
THEODHORI SOLLAKU